

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Praktika pedagogjike 1
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i parë (semestri i dytë)
Numri i orëve në javë:	3+0
Vleranë kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	14:00 – 15:30 / Salla e informatikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Fitore Abdullahu
Detajet kontaktuese:	fitore.abdullahu@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës	<p>Mësimi praktik përfshinë dy komponente të ndara, por të lidhura ngushtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mësimin praktik në Fakultet (përgatitja teorike) i cili ka dy qëllime primare: (i) t'u ofrojë studentëve përgatitjen që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe (ii) t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë. 2. Mësimi praktik në shkollë i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës.
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi parësor i komponentës së mësimin praktik është që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathhtësitë për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenta e mësimin praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analizojnë funksionin pedagogjik të praktikës mësimore 2. Njoftohen me shkollën dhe ambientin fizik e social në shkollë 3. Vëzhgojnë dhe reflektojnë mbi aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë. 4. Analizojnë dhe gjykojnë mbi praktikën e mësimdhënies 5. Zhvillojnë shkathhtësi të vetëorganizimit dhe raportimit

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Totali i orëve
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike	0	0	0
Punë praktike	1	15	15
Konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	5	7	35

Kollokfiume	0	0	0
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak	1	5	4
Përgaditja për provim	1	5	4
Koha e kaluar në vlerësim	1	3	3
Projektet	1	5	4
Totali			131 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënie aktive, diskutim, punë e pavarur e studentëve dhe konkretizim.		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:	1. Pjesëmarrja -- 5% 2. Detyrat e shtëpisë -- 5% 3. Vlerësimi 1 -- 25 % 4. Vlerësimi 2 -- 25 % 5. Provimi -- 40 %		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Fakulteti i Edukimit. (2017) Doracaku për mësimin praktik. 2. MASHT (2011). Korniza e Kurrikulës së Kosovës 3. MASHT. Kurrikulat bërthamë (sipas natyrës së programit lëndor)		
Literatura shtesë:	Artikuj mbi shkrimin reflektiv, ditarin e studentit dhe vetëvlerësimin (të rekomanduara nga profesori i kursit)		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata		
Java e parë	Përshkrimi i kursit/ Rëndësia e ndërlidhjes së teorisë me praktikën mësimore-Parimet udhëzuese		
Java e dytë	Politikat dhe procedurat e përgjithshme		
Java e tretë	Rolet dhe përgjegjësitë e studentëve, mentorëve dhe mbikqyrësve nga fakulteti		
Java e katërt	Kodi i mirësjelljes profesionale të studentëve		
Java e pestë	Organizimi i portfolios dhe ditarit reflektiv		
Java e gjashtë	Vëzhgimi dhe shkrimi reflektiv		
Java e shtatë	Mësim praktik në shkollë (e hënë – e premte)		
Java e tetë	Mësim praktik në shkollë (e hënë- e premte)		
Java e nëntë	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek komunikimi		
Java e dhjetë	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek menaxhimi i klasës		
Java e njëmbëdhjetë	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek planifikimi		
Java e dymbëdhjetë	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek vlerësimi		
Java e trembëdhjetë	Reflektime mbi orët mësimore -fokusimi tek metodat /teknikat e mësimdhënies		
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i portfoliove -minikonferencë		
Java e pesëmbëdhjetë	Prezantimi i portfoliove- minikonferencë		
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:			
<ul style="list-style-type: none"> - Studenti me 3 mungesa pa arsye e humb të drejtën për t’iu nënshtruar vlerësimeve; - Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë përveç në raste kur kërkohet nga mësimdhënësi si mjet mësimor; - Secili student ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala; - Asnjë student nuk ka të drejtë t’i ndërhyjë kolegut kur ai/ajo e ka fjalën; - Lejohet “zhurma” e punës kur studentët punojnë në grupe; - Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezantohet puna e studentëve; - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme - Nuk lejohet asnjë formë e kopjimit - Për secilën shkelje studentit do të raportohet në komisionin disiplinor të fakultetit nëpërmjet një raporti me shkrim. 			

